



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

SHKURT 2026

BULETINI MUJOR

MINISTRIA E MJEDISIT



➤ Shqipëri-Francë: Partneritet Strategjik për Reformën e Mbetjeve

U nënshkrua Memorandumi mes AKEM dhe SUEZ gjatë vizitës së Ministrit francez Nicolas Forissier. Marrëveshja forcon ndërtimin e një sistemi të integruar të menaxhimit të mbetjeve sipas standardeve të BE-së dhe parimeve të ekonomisë qarkulluese.



Nis "Vjosa e Gjelbër" me Mbështetjen Gjermane ➤

Projekti i ri në Parkun Kombëtar të Vjosës promovon mbrojtjen e natyrës, fuqizimin e komuniteteve lokale dhe zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, në përputhje me Kapitullin 27.

➤ "Ballkone Panoramike" në Parqet Kombëtare

Finalizohen 12 pika të reja vërtetimi në zona me potencial ekoturistik, duke rritur cilësinë e përvojës së vizitorëve dhe ofertën e turizmit të qëndrueshëm.



Syri i Kaltër – Model i Ekoturizmit Modern ➤

Me mbi 226 mijë vizitorë në 2025, parku konsolidohet si model suksesi falë biletarisë elektronike, sinjalistikës së re dhe menaxhimit të integruar.

➤ Përparon Infrastruktura e Mbetjeve në Jug

Projekti #EU4CE – #ReWaM koordinon 12 bashki; stacionet e reja të transferimit rrisin efikasitetin dhe ulin kostot për qytetarët.



Kapitulli 27 – Përsheptim i Reformave ➤

Thellohet koordinimi ndërinstytucional dhe puna për paketat ligjore për të rritur ritmin e përafrimit me standardet e BE-së.

➤ Monitorim i Ri në Lumin Shkumbin

Zbatohet metodologjia ndërkombëtare OSPAR për identifikimin e burimeve të ndotjes, me përfshirjen e të rinjve në proces.




Trajnime për Zonat e Mbrojtura ➤

Në kuadër të #EU4Nature, zhvillohen trajnime për monitorim me teknologji të avancuara dhe forcim kapacitetesh.

↘ Bashkëpunim Rajonal me Maqedoninë e Veriut

Rikonfirmohet angazhimi për mbrojtjen e Liqenit të Ohrit dhe Prespës, menaxhimin e zjarreve dhe monitorimin e biodiversitetit.



SIM Online – Shërbime Digjitale Mjedisore

Platforma SIM ofron 9 shërbime online, duke reduktuar burokracinë dhe rritur transparencën për qytetarët dhe bizneset.

↘ Smart Forest Disaster App

Aplikacioni i ri mundëson raportimin në kohë reale të zjarreve në pyje, duke përmirësuar reagimin institucional.

